

“Unë Jam Udha, e Vërteta dhe Jeta”

MANUALI I SEMINARIT PËR DHIATËN E RE

Jezu Krishti është “udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6)

Lexo te Gjoni 14:1–6, duke kërkuar se si Shpëtimtari premtoi t’i ndihmojë ata që e ndjekin Atë.

- Çfarë të vërtetash dha mësim Shpëtimtari në këto vargje?
- Si e quajti Shpëtimtari Vetën te vargu 6?
- Çfarë të mëson secili nga këta tituj për Jezu Krishtin dhe marrëdhënien tënde me Të?

Nëse krijove një listë të titujve dhe roleve të ndryshme të Jezu Krishtit në një mësim të mëparshëm, mund të duash t’i shtosh asaj atë që zbulove te Gjoni 14. Libri i Mormonit mund ta rritë kuptueshmërinë tënde për atë që po studion në Dhiatën e Re. Lexo te Mosia 3:17 dhe mendo se si ky varg na ndihmon ta kuptojmë më mirë vargun te Gjoni 14:6. Presidenti Diter F. Uhtdorf, në atë kohë i Presidencës së Parë, dha mësim:



“Perëndia dëshiron që ju ta gjeni udhën e kthimit tek Ai dhe Shpëtimtari është udha [shih Gjoni 14:6]. Perëndia dëshiron që ju të mësoni për Birin e Tij, Jezu Krishtin, e të përjetoni paqen dhe gëzimin e thellë që vijnë nga ndjekja e shtegut të dishepullimit hyjnor.” (Diter F. Uhtdorf, “Marrja e një Dëshmie për Dritën dhe të Vërtetën”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 21)

- Kur e ke përjetuar ti ose një person që ti njeh, paqen dhe gëzimin e thellë që vijnë nga ndjekja e Jezu Krishtit?

Për të parë një shembull të dikujt që e gjeti Shpëtimtarin dhe u bekua duke e ndjekur Atë, nëse është e mundur, shih materialin filmik “Jesus Christ Is the Way” [“Jezu Krishti Është Udha”] (05:02), në dispozicion në ChurchofJesusChrist.org.

- Cilat janë disa mënyra se si ne mund ta ndjekim Shpëtimtarin për t’u kthyer tek Ati Qjellor?
- Si mund ta kuptojmë nëse jemi në rrugën e duhur?

Jezu Krishti është hardhia (Gjoni 15:5)

Jezu Krishti përdori një krahasim për t’i mësuar dishepujt e Tij për marrëdhënien e tyre me Të. Lexo te Gjoni 15:1–11 duke kërkuar këtë krahasim. Nëse krijoje një listë të titujve dhe roleve të ndryshme të Jezu Krishtit në një mësim të mëparshëm, mund të duash t’i shtosh asaj atë që zbulove te Gjoni 15.

- Çfarë mendon se po na mëson Jezu Krishti me këtë krahasim?
- Cilat të vërteta mund të mësosh nga ky krahasim për marrëdhënien tonë me Jezu Krishtin?

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi që ftesa e Shpëtimtarit për të qëndruar në Të është një ftesë që ne “të mbetemi, të ... qëndrojmë *përgjithmonë*” (“Abide in Me”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2004, f. 32). Plaku Holland shpjegoi se përse është kaq shumë e rëndësishme që ne të pranojmë ftesën e Shpëtimtarit për të qëndruar në Të. Mund të duash të shohësh materialin filmik “Abide in Me” [“Qëndroni në Mua”] nga kodi kohor 13:26 deri në 14:23, ose lexo thënien vijuese.



“Jezusi tha: ‘Pa mua nuk mund të bëni asgjë’ [Gjoni 15:5]. Unë dëshmoj se ajo është e vërteta e Perëndisë. Krishti është gjithçka për ne dhe ne duhet të ‘qëndrojmë’ në Të në mënyrë të përherëshme, të patundur, të qëndrueshme, përgjithmonë. Që fryti i ungjillit të lulëzojë dhe ta bekojë jetën tonë, ne duhet të bashkohemi në mënyrë të palëkundshme me Të, Shpëtimtarin e të gjithëve ne, dhe me këtë Kishë të Tij, e cila mban emrin e Tij të shenjtë. Ai është hardhia që është burimi ynë i vërtetë i forcës dhe i vetmi burim i jetës së përjetshme. Në Të ne jo vetëm do të durojmë, por edhe do të dalim ngadhënjimtarë e triumfues në këtë kauzë të shenjtë që kurrë nuk do të na bëjë të dështojmë.” (Jeffrey R. Holland, “Abide in Me”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2004, f. 32)

Libri i Mormonit mund të të ndihmojë ta rrisësh kuptueshmërinë tënde për atë që po studion në Dhiatën e

Re. Lexo tek Alma 26:12 dhe mendo se si ajo lidhet me vargjet te Gjoni 15:1–11.

- Cilët janë disa nga frytet (rezultatet ose bekimet) që ke parë në jetën tënde teksa je përpjekur të qëndrosh në Jezu Krishtin?
- Cilat janë disa veprime që mund të ndërmarrësh për të të ndihmuar të qëndrosh në Jezu Krishtin?